

RAPORTI NDËRKOMBËTAR MBI LIRINË FETARE NË MAQEDONINË E VERIUT PËR VITIN 2021

Përmbledhje Ekzekutive

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe parashikon lirinë e fesë dhe shprehjen fetare. Ajo siguron barazi para ligjit për të gjithë individët, pavarësisht nga besimi fetar. Ministria e Drejtësisë (MD) dhe ministri të tjera të qeverisë diskutuan amendamente të ligjit të vitit 2007 që rregullon fenë që do të bënte të mundur që komunitetet më të mëdha fetare të merrnin statusin e "subjekteve ligjore," por MD shtyu përsëri konsultimet me grupet fetare për këto amendamente. Më 18 shkurt, Bashkësia Fetare Islame në Maqedoninë e Veriut (BFI) dënoi publikisht regjistrimin zyrtar nga ana e qeverisë të komunitetit islam salafist në dhjetor 2020, duke thënë se kjo do të ishte në dëm të unitetit mysliman. Krerët e BFI-së thanë se marrëdhëniet me qeverinë u përmirësuan pas një takimi në janar midis kreut të BFI-së Reis Shaqir Fetahu dhe presidentit Stevo Pendarovski, por se disa ministri dhe gjyqësori vazhduan ta trajtojnë organizatën në mënyrë të pafavorshme. Gjykata e Apelit e Shkupit mbështeti kundërshtimin e një gjykate të shkallës më të ulët të kërkesës për regjistrimin e Kryepeshkopatës Ortodokse të Ohrit (KOO) sepse kërkesa nuk ishte paraqitur deri në afatin përfundimtar. KOO vazhdoi të deklaronte se kishte ndërhyrje të dëmshme të qeverisë në punët e Kishës. Gjykata Themelore Civile e Shkupit vendosi në maj se Komuniteti Bektashian (një grup sufist) me qendër në Tetovë mund të riparaqesë kërkesën e tij për t'u regjistruar si grup fetar; komuniteti nuk e parashittoi kërkesën gjatë vitit. Anëtarët e Komunitetit Bektashi (Tetovë) raportuan përsëri ngacmime nga qeveria dhe BFI-ja. BFI tha se qeveria vazhdoi të favorizonte Kishën Ortodokse Maqedonase-Kryepeshkopata e Ohrit (KOM-KO) dhe grupet më të vogla fetare vazhduan të raportojnë trajtim të pabarabartë të qeverisë krahasuar me pesë grupet e emëruara në kushtetutë. Përfaqësuesit e BFI-së thanë se qeveria vonoi akreditimin e shkollave të mesme islamike të drejtuara nga BFI, me çka nxënësit u penguan të regjistroheshin në universitetet e financuara nga shteti. Në një intervistë në prill, gruaja e parë hebreje e vendit që ishte bërë ministre që nga pavarësia e vendit tha se ishte ballafaquar me antisemitizmin kur ishte shkarkuar nga kabineti në vitin 2020 pas daljes së saj në një konferencë shtypi përpara një sfondi që shfaqte emrin e mëparshëm të vendit, Republika e Maqedonisë.

Zyrtarët e KOO vazhduan të thonë se kleri i tyre dhe anëtarët e familjes së tyre qenë shpesh objekt fyerjesh në media dhe viktime të sulmeve fizike nga individë që konsideroheshin të afërt me KOM-KO. Komuniteti Bektashian (Tetovë) vazhdoi të kundërshtonte pretendimet e BFI-së për pronësi të plotë dhe planet për të rinovuar Harabati Baba Teqenë, një kompleks që Komuniteti Bektashian (Tetovë) e përdor si seli të veten. Media raportoi një incident vandalizmi ndaj një manastiri të vendosur

në një zonë me shumicë myslimane si dhe 18 incidente vjedhjesh në kisha gjatë vitit. KOM-KO nuk ia mveshi vjedhjet dhe vandalizmin motiveve fetare.

Ambasadorja amerikane dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës diskutuan mbi dialogun ndërfaqësor dhe rëndësinë e tolerancës dhe mirëkuptimit midis grupeve të ndryshme fetare me përfaqësues të qeverisë, përfshirë drejtorin e Komisionit për Marrëdhëniet ndërmjet Bashkësive dhe Grupeve Fetare (KMBFGR), kryetarët e komunave dhe zyrtarë të tjerë. Me deputetët, ata diskutuan gjithashtu gjendjen e lirisë fetare në vend, kthimin e pronës fetare dhe amendamentet e ligjit për shkollat e mesme, duke përfshirë akreditimin e shkollave fetare. Zyrtarët e ambasadës u takuan me Kryepeshkopin e KOM-KO Stefan dhe kreun e BFI Fetahu për të diskutuar çështjet e lirisë fetare, duke përfshirë favorizimin e perceptuar të qeverisë ndaj disa grupeve fetare. Ata u takuan gjithashtu me përfaqësues të grupeve të tjera fetare për të diskutuar trajtimin nga qeveria të grupeve më të vogla dhe respektimin e lirisë së tyre fetare. Gjatë gjithë vitit, ambasada përdori mediat sociale për të shpërndarë mesazhe që theksonin rëndësinë e lirisë fetare.

Seksioni I. Demografia Fetare

Qeveria amerikane vlerëson se popullsia e përgjithshme ishte 2.1 milion (mesi i vitit 2021), duke përfshirë diasporën. Sipas regjistrimit shtetëror të vitit 2021, 46.1 për qind e popullsisë janë të krishterë ortodoksë, shumica dërrmuese e të cilëve janë ndjekës të KOM-KO; 32.2 për qind myslimanë (shumica e madhe e të cilëve janë sunitë); 13.2 për qind të krishterë (pa specifikuar një emërtim); dhe 7.2 përqind të panjohur. Grupe të tjera fetare që së bashku përbëjnë më pak se 2 për qind të popullsisë përfshijnë një numër të vogël grupesh sufiste me disa urdhra bektashianë, KOO, katolikë, emërtime të ndryshme protestante, Dëshmitarë të Jehovait dhe Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Komuniteti hebre vlerëson se ka 200 anëtarë.

Shumica e të krishterëve ortodoksë jetojnë në rajonet qendrore dhe juglindore. Shumica e myslimanëve jetojnë në pjesën veriore dhe perëndimore të vendit. Ekziston ndërlidhje mes përkatësisë etnike dhe asaj fetare – shumica e të krishterëve ortodoksë janë maqedonas etnikë, ndërsa shumica e myslimanëve janë shqiptarë etnikë. Shumica e romëve dhe të gjithë turqit dhe boshnjakët janë myslimanë, ndërsa shumica e serbëve dhe vllahëve janë të krishterë ortodoksë. Ekziston gjithashtu një korrelacion midis përkatësisë fetare dhe politike, pasi partitë politike janë kryesisht të ndara përgjatë vijave etnike.

Seksioni II. Gjendja e respektimit të lirive fetare nga ana e Qeverisë

Kuadri Ligjor

Kushtetuta ndalon diskriminimin fetar dhe siguron barazinë e të drejtave për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga besimi fetar. Ajo siguron lirinë e fesë dhe të drejtën e individëve për të shprehur besimin e tyre lirisht dhe në publik, individualisht ose me të tjerët. Kushtetuta mbron gjithashtu identitetin fetar të të gjitha bashkësive.

Sipas Kushtetutës kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të zbatohet për bindjen personale, ndërgjegjen, mendimin ose rrëfimin fetar. Një ndryshim i kushtetutës përmend pesë grupe fetare që janë të liruara nga taksat dhe kanë përfitime të tjera: Kisha Ortodokse Maqedonase, BFI, Kisha Katolike, Kisha Metodiste Ungjillore dhe Komuniteti Hebre. Ajo përcakton që këto pesë grupe, si dhe grupet e tjera të regjistruara, janë të ndara nga shteti, të barabarta para ligjit dhe të lira për të krijuar shkolla, bamirësi dhe institucione të tjera shoqërore. Ligji mundëson që organizatat e tjera fetare t'i kenë të drejtat e njëjta dhe statusin ligjor si këto pesë grupe duke aplikuar për njohje nga Qeveria dhe regjistrim përmes gjykatës. Kushtetuta i ndalon partitë politike apo shoqatat e tjera që të nxisin urrejtje ose mostolerancë fetare

Ligji përkufizon krimet e urrejtjes si vepra penale kundër një personi, personi juridik, ose personave dhe pronës, të kryer për shkak të një karakteristike të vërtetë ose të supozuar të viktimës, përfshirë kombësinë, origjinën etnike dhe fenë ose besimin e viktimës. Gjuha e urrejtjes dhe krimet e urrejtjes janë krime; autorët e krimeve të tjera mund të marrin dënime më të ashpra kur përfshihen elementë të krimit të urrejtjes. Dënimet sillen nga një deri në 10 vjet burg dhe minimumi prej 10 vjet burg për krime të urrejtjes që çojnë në vdekje.

Organizatat fetare mund të kërkojnë të regjistrohen si "kishë", "bashkësi fetare" ose "grup fetar". Këto klasifikime bazohen në madhësinë e grupit, organizimin e brendshëm dhe hierarkinë e brendshme. Ligji i trajton këto tre kategori në mënyrë të barabartë, duke iu dhënë të njëjtat të drejta, përfitime dhe detyrime ligjore. Qeveria njih 40 organizata fetare, duke përfshirë edhe ato pesë që i përmend Kushtetuta. Ka gjithsej 18 kisha, 10 bashkësi fetare dhe 12 grupe fetare. Pasi të jetë regjistruar, një kishë, një bashkësi fetare ose një grup fetar lirohet nga taksat dhe ka të drejtë të aplikojë për kthimin e pronës të nacionalizuar gjatë epokës komuniste (me kusht që grupi ose komuniteti të ekzistonte dhe të kishte prona gjatë asaj periudhe), për projektet e financuara nga qeveria dhe për lejet e ndërtimit për ruajtjen e vendeve të shenjta dhe vendeve kulturore. Ajo gjithashtu mund të themelojë shkolla. Grupet e paregjistruara mund të zhvillojnë shërbime fetare ose takime të tjera dhe të predikojnë, por nuk mund të angazhohen në veprimtari të caktuara, siç janë krijimi i shkollave ose marrja e donacioneve të cilat e lirojnë donatorin nga taksat për to, ndërsa grupet e tilla nuk janë të liruara nga taksat.

Gjykata Themelore e Shkupit i pranon aplikimet për regjistrim dhe në afat prej 15 ditë pune duhet të vendosë nëse aplikimi i organizatës fetare i përmbushë kriteret

ligjore për regjistrim. Kriteret përfshijnë një prani fizike administrative brenda vendit, një shpjegim të besimeve dhe praktikave të tij që e dallojnë atë nga organizatat e tjera fetare dhe një emër të vetëm dhe emblemë zyrtare. Kërkesa e organizatës duhet të identifikojë gjithashtu një organ mbikëqyrës të ngarkuar me menaxhimin e financave të saj dhe të paraqesë një ndarje të aseteve të saj financiare dhe burimeve të financimit, si dhe procesverbalin nga mbledhja themeluese. Ligji lejon regjistrimin e më tepër grupeve të fesë së njëjtë. Krerët ose përfaqësuesit ligjor të grupeve fetare të regjistruara të jenë shtetas të vendit.

Gjykata ia dërgon aplikacionet e aprovuara Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (KMBFGR), një organ qeveritar përgjegjës për promovimin e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet qeverisë dhe grupeve fetare i cili i shënon organizatat në Regjistrin e tij. KMBFGR nuk ka qasje ose mundësi për të ndikuar në procesin e regjistrimit. Nëse gjykata e refuzon kërkesën, organizata mund ta ankimojë vendimin në gjykatën e apelit. Nëse gjykata e apelit hedh poshtë ankesën, organizata mund të paraqesë një parashtrësë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Gjykatën Kushtetuese, e cila është gjykata më e lartë në vend që ka juridiksion mbi çështjet e të drejtave të njeriut. Nëse Gjykata Kushtetuese e hedh poshtë parashtrësën, organizata mund ta apelojë më tej çështjen në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ).

Ligji nuk lejon që organizatat fetare të veprojnë në shkollat fillore, por i lejon të veprojnë në shkollat e mesme dhe më lart. Shkollat e mesme fetare përdorin programet e tyre dhe nuk kërkohet të akreditohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, megjithëse disa janë të akredituara. Nxënësit në shkollat e mesme fetare pa akreditim nuk lejohen të japin provimin e detyrueshëm të maturës shtetërore dhe për këtë arsye nuk mund të regjistrohen në universitete. Plan-programi e ministrisë kërkon që nxënësit e klasave të gjashta të ndjekin një nga tre lëndët zgjedhore, dy prej të cilave kanë përmbajtje fetare – Hyrje në religjione dhe Etika fetare. Sipas përkrahimit të ministrisë, këto lëndë paraqesin fenë në një mënyrë akademike, jofetare. Ministria e Arsimit dhe Shkencës shpesh akrediton priftërinjtë dhe hoxhallarët, në varësi të kërkesës së prindërve, për të dhënë mësim në këto lëndë. Ministria urdhëron që të gjithë mësimdhënësit e këtyre lëndëve të kenë përfunduar trajnimin në institucionet e akredituara të arsimit të lartë ku mësim kanë dhënë profesorë të filozofisë ose sociologjisë. Nëse nxënësit nuk dëshirojnë të ndjekin lëndën mbi fenë, ata mund të zgjedhin opsionin e tretë, Kultura klasike në qytetërimin evropian.

Të gjithë të huajt që kërkojnë të hyjnë në vend për të kryer punë fetare apo për të kryer ritet fetare duhet të marrin një vizë pune përpara mbërritjes, një proces që normalisht kërkon afërsisht katër muaj. KMBFGR mban një regjistër të të gjithë punonjësve të huaj fetarë dhe zyra të ndryshme qeveritare mund të miratojnë ose t'u

mohojnë atyre të drejtën për të kryer punë fetare brenda vendit. KMBFGR lëshon miratime për leje qëndrimi të përkohshëm dhe/ose aplikime për viza pune për misionarët dhe punonjësit fetarë në emër të kishave të regjistruara, bashkësive fetare dhe grupeve fetare. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale verifikon pajtueshmërinë e tyre me ligjet e punës në vend. Ndërsa Ministria e Brendshme shqyrton aspektet e sigurisë. Grupet e peregjistruara mund të paraqesin kërkesa për leje pune dhe viza sipas procedurës normale. Vizat e punës janë të vlefshme për gjashtë muaj, me mundësinë për t'u rinovuar për gjashtë muaj të tjerë. Rinovimet e mëvonshme janë të vlefshme për një vit. Nuk ka kufizim të numrit të rinovimeve të vizave për të cilat mund të aplikojë një punonjës fetar.

Vendi është palë në Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.

Praktikat qeveritare

Në shkurt, MD u takua me KMBFGR dhe ministritë dhe agjencitë e tjera qeveritare për të diskutuar ndryshimet në Ligjin për Statusin Ligjor të Kishës, Bashkësisë Fetare dhe Grupeve Fetare të vitit 2007 që do të mundësonin që komunitetet më të mëdha fetare të marrin statusin e "subjekteve ligjore". Ky ndryshim, një kërkesë e kamotshme e KOM-KO dhe BFI, do t'i mundësonte qeverisë të mbështeste projektet e grupeve fetare kur kjo të konsiderohej në interes të publikut. Sipas ligjit ekzistues, qeverisë i mungon autoriteti i qartë për të ndihmuar, për shembull, me ruajtjen e vendeve fetare të rëndësishme nga pikëpamja kulturore apo historike. Ndryshime të tjera të propozuara në ligjin e vitit 2007 do ta përfronin atë më tepër me dispozitat ekzistuese të kodit penal dhe ligjeve të tjera duke specifikuar se grupet fetare nuk mund të nxisin mostolerancën kundër grupeve të tjera fetare ose të nxisin stereotipat e grupeve të tjera; të përdorin/abuzojnë emrat, titujt ose shenjat e tyre; të veprojnë kundër rendit ligjor, moralit publik, ose shëndetit dhe jetës së tyre ose të besimtarëve të një grupi tjetër fetar; ose të nxisin urrejtjen fetare, etnike, kombëtare ose racore, ose të nxisin radikalizmin fetar. MD vendosi, siç bëri kur u soll ligji i vitit 2007, të ftojë grupet fetare, duke përfshirë KOM-KO dhe BFI, në diskutim që do të mbahej më vonë, pa përcaktuar kohën, sapo amendamentet të ishin hartuar.

Gjykata Civile Themelore e Shkupit njoftoi se kishte marrë 10 aplikime gjatë vitit lidhur me regjistrimin e kishave dhe komuniteteve/grupeve fetare. Gjykata lëshoi vendime për nëntë prej tyre dhe një, lidhur me regjistrimin e një kisha të re, mbeti pezull në fund të vitit. Nuk kishte detaje të tjera mbi rastin në pritje.

Më 18 shkurt, BFI publikisht dënoi regjistrimin e Bashkësisë Islame Salafiste në dhjetor 2020, duke e quajtur vendimin e Gjykatës Themelore Civile të Shkupit "një akt të njëanshëm, të turpshëm në dëm të unitetit të myslimanëve" dhe "një përpjekje për të krijuar institucione paralele." Zyrtarët e BFI-së thanë se grupi salafist ishte "një pasardhës i strukturave keqdashëse" dhe u bëri thirrje myslimanëve në vend që

"të mos bien pre" e këtij grupi. Udhëheqësi i komunitetit salafist tha se regjistrimin e grupit të tij e shihte si një çështje të së drejtës të "lirisë së shprehjes dhe praktikës fetare" dhe se grupi i tij kishte "një formë tjetër organizimi dhe administrimi".

Gjykata Themelore Civile e Shkupit vendosi më 18 maj se Komuniteti Bektashian (Tetovë) mund të riparaqesë kërkesën e tij për t'u regjistruar si një grup fetar, pas vendimit të gjykatës së apelit në shtator 2020 që grupi të lejohet ta bëjë këtë. Komuniteti Bektashian (Tetovë), megjithatë, nuk e parashtrori kërkesën për regjistrim gjatë vitit. Në vitin 2019, raporti vjetor i Komisionit Evropian për vendin i bëri thirrje qeverisë të zbatojë vendimet e mëparshme të GJEDNJ-së për të respektuar të drejtat e Komunitetit Bektashian (Tetovë), përfshirë njohjen zyrtare të tij si një grup fetar. Grupi tha se mosregjistrimi i tij kufizoi efektivisht aftësinë e komunitetit për të marrë prona dhe për të përdorur mjedise, të tilla si kompleksi Harabati Baba Teqe, për veprimtari fetare.

KOO vazhdoi të deklarojë se kishte ndërhyrje të dëmshme të qeverisë në punët e saj. Autoritetet e KOO-së vazhduan të thonë se qeveria refuzoi të regjistrojë grupin, ndërhyri në punën e gjyqësorit në rastet që përfshinin KOO-në dhe ushtroi presion mbi KOO-në për të riaplikuar për regjistrim nën një emër të ri pavarësisht nga vendimi i GJEDNJ-së me të cili kërkohet që t'i lejohet të regjistrohet nën emrin e saj aktual. Zyrtarët qeveritarë thanë se vendimet e GJEDNJ-së nuk ndryshuan kushtin ligjor në vend që emri i aplikuesit të jetë i ndryshëm nga një grup fetar tashmë i regjistruar. Në vitin 2020, Gjykata Themelore Civile e Shkupit deklaroi se emri i KOO-së ishte shumë i ngjashëm me emrin e KOM-KO-së dhe do të duhej të ndryshohej që KOO të regjistrohet. Në mars, Gjykata e Apelit e Shkupit konfirmoi pa koment refuzimin e regjistrimit të KOO-së, në pritje që nga viti 2009.

KOM-KO tha se procesi i denacionalizimit (kthimit të pronës) vazhdoi të zvarritet, duke vënë në dukje se më shumë se 90 për qind e vendimeve pozitive të marra nga Komisioni i Denacionalizimit, i cili trajton këto kërkesa, u ankimuan nga Zyra e Avokaturës së Shtetit. Ata thanë se procesi i kthimit u zvarrit për një vit sepse komisioni u mbyll për shkak të KOVID-19 dhe rastet në pritje u rishpërndanë në komisionet lokale të denacionalizimit. Komisionet lokale nuk vepruan mbi ndonjë kërkesë kthimi të KOM-KO-së gjatë vitit.

Për të dhjetin vit me radhë, Komuniteti Bektashian (Tetovë) denoncoi në polici akte ngacmimi nga individë që qëndronin në kompleksin e teqesë Harabati Baba në Tetovë dhe nga një grup mbështetësish të urdhrat të regjistruar bektashian të teqesë Hadër Baba (Kërçovë), të cilët u përpoqën të dëbojnë krerët e komunitetit të Tetovës nga faltarja e tyre. Grupi bektashian i Tetovës deklaroi se më 22 korrik, individë të paautorizuar hynë në kompleksin e tyre dhe vodhën paratë e dhuruara. Grupi i paautorizuar u përpoq dy herë të dëbonte klerikun rezident – dervishin – në gusht

dhe në shtator. Në incidentin e shtatorit, një prokuror publik i lidhur me grupin e paautorizuar, i shoqëruar nga dy inspektorë policie kërcënoi dervishin dhe punonjësit e tjerë të komunitetit Bektashi (Tetovë) me dëbim nga faltorja. Komuniteti Bektashian (Tetovë) tha gjithashtu se më 13 shtator, policia ngacmoi dhe mori në pyetje një nga klerikët e saj. Komuniteti Bektashian (Tetovë) mbeti në objektin e Harabati Baba Teqesë në fund të vitit të kaluar.

Më 13 janar, presidenti Pendarovski e ftoi për takim kreun e BFI-së, Reis Shaqir Fetahun. Gjatë takimit, Pendarovski tha se beson se Fetahu do të japë një kontribut të rëndësishëm në promovimin e bashkëjetesës fetare dhe të respektit për diversitetin. Të dy diskutuan gjithashtu rreth lirisë fetare dhe mundësinë e organizimit të Konferencës së ardhshme botërore për dialogun ndërmjet feve dhe qytetërimeve (e fundit u mbajt në Manastir në vitin 2016).

Drejtuesit e BFI-së thanë se marrëdhëniet me qeverinë u përmirësuan pas takimit Pendarovski-Fetahu, por se disa ministri dhe gjyqësori vazhduan ta trajtojnë BFI-në në mënyrë të pafavorshme. BFI tha se gjatë vitit, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) nuk kishte përfunduar asnjë hetim të incidenteve që prekin bashkësinë dhe udhëheqësinë e saj, disa prej të cilave datojnë që nga viti 2015. Zyrtarët e BFI-së thanë gjithashtu se Njësia e Krimet Kibernetik e MPB-së mbylli një faqe interneti që përmbante komente antisemite, por nuk ndërmori asnjë veprim kundër gjuhës së urrejtjes në internet ose thirrjeve për dhunë kundër udhëheqësve të BFI-së, pavarësisht nga fakti se BFI ngriti akuza.

BFI tha se qeveria kishte kthyer më pak se 50 për qind të pronës së saj të marrë nga shteti para vitit 1991. Midis pronave të kontestuara ishte Xhamia Husamedin Pasha në Shtip (e nacionalizuar më 1955), disa xhami në Shkup, Jeni Xhamia në Manastir dhe Xhamia e Çarshisë në Prilep (e cila mbeti në rrënoja). BFI shtoi se niveli i kompensimit për pronën e saj ishte shpesh nën vlerën e tregut.

Në maj, BFI rimori pronësinë mbi pronën e saj në Çarshinë e Vjetër të Shkupit dhe disa parcela toke në Gostivar përmes procesit të denacionalizimit.

BFI deklaroi se autoritetet komunale vazhduan të refuzojnë kërkesat për leje ndërtimi për një xhami në fshatin Llazhec ku banojnë bashkësi të ndryshme etnike dhe fetare, si dhe për rindërtimin e një xhamie në Strumicë dhe xhaminë qendrore në Prilep, me arsyetimin se bëhej fjalë për monumente kulture nën juridiksionin e qeverisë, e jo të BFI-së.

Kisha Ungjillore Metodiste në Maqedoni (KUM), pjesë e Kishës Metodiste të Bashkuar në Shtetet e Bashkuara, tha se kthimi i pronës së Kishës mbeti i paplotë, ndërsa procesi i kthimit të KOM-KO përfundoi shumë kohë më parë. KUM tha se nuk mund të ndërtonte një kishë në Prilep sepse komuna kishte refuzuar për më

shumë se 20 vjet të lëshonte një leje ndërtimi edhe pse në atë pronë kishte pasur një kishë në atë pronë për më shumë se 100 vjet dhe se planet e zonimit e lejonin një kishë aty. KUM tha se u ndesh me probleme të ngjashme në qytete të tjera.

KOM-KO tha se Komuna e Tetovës dy vjet nuk i kishte respektuar angazhimet e saj të mëparshme për të shtruar rrugën e njërës nga kishat e saj të një lagjeje, ose për të ndërtuar një kapelë të varrezat, si dhe për të mbledhur plehrat në hyrje të varrezave. KOM-KO tha gjithashtu se komuna e Strugës ende nuk kishte vendosur mbi një kërkesë, në pritje që nga viti 2013, për ndërtimin e një kisha ortodokse në fshatin Oktis.

Grupet më të vogla fetare vazhduan të thonë se qeveria i trajtonte ata në mënyrë të pabarabartë dhe favorizonte grupet fetare të renditura në kushtetutë. Ata thanë se kryeministri Zoran Zaev, presidenti Pendarovski dhe zyrtarë të tjerë qeveritarë shpeshherë janë takuar vetëm me pesë grupet e njohura në kushtetutë.

KUM tha se qeveria privilegjonte më shumë KOM-KO-në dhe BFI-në dhe këto grupe kishin më shumë të drejta se grupet e tjera fetare. Në tetor, BFI deklaroi se qeveria angazhohej për njohjen ndërkombëtare të KOM-KO-së dhe vazhdonte t'i jepte privilegje të veçanta, duke i dhënë pronë publike falas. Krerët e KOM-KO-së dhe BFI-së thanë se ankesat për favorizimin e qeverisë lindën nga perceptimi i gabuar për shkak të madhësisë së komuniteteve të tyre dhe pranisë më të gjerë në vend.

KOO vazhdoi të akuzojë qeverinë për njëanshmëri dhe mosrespektim të së drejtës vendase dhe ndërkombëtare. Zyrtarët e KOO-së thanë se si përfaqësues të një entiteti të peregjistruar ata nuk kishin të drejtë të hapnin një llogari bankare dhe se vazhdonin të ndesheshin me pengesa të tjera ligjore.

KUM dhe BFI thanë se Këshilli Ndërfetar, i përbërë nga krerët e pesë grupeve fetare të njohura me kushtetutë, nuk ishte aq aktiv sa duhej dhe mbajti vetëm dy takime gjatë vitit: një takim në janar lidhur me pandeminë e KOVID-19 dhe një takim zyrtar me presidentin Pendarovski në prill.

Kisha Ortodokse Serbe (KOS) vazhdoi të njohë KOO-në dhe refuzoi të njohë KOM-KO-në e cila e la këtë të fundit, komunitetin më të madh ortodoks në vend, të papranuar nga kishat ortodokse anembanë botës. Në qershor, Presidenti Pendarovski u takua në Stamboll me Patriarkun Ekumenik Bartholemeu I për të diskutuar statusin e KOM-KO-së. Pendarovski theksoi rolin e posaçëm që Patriarku Ekumenik mund të luajë në kapërcimin e mosmarrëveshjes për autoqefalinë midis KOM-KO-së dhe KOS-it. KOM-KO kërkoi autoqefalinë nga KOS në mënyrë që të njihej nga autoritetet e kishës në Stamboll.

BFI tha se mbështet autoqefalinë e KOM-KO dhe në shenjë solidariteti vazhdoi të shmangte veprimtaritë e organizuara nga KOS në qoftë se në to nuk merrte pjesë edhe KOM-KO.

Megjithëse parlamenti ndryshoi Ligjin për Arsimin e Lartë në vitin 2020, disa çështje që lidhen me akreditimin e shkollave të mesme fetare, provimet e maturës dhe mundësinë e nxënësve që kishin mbaruar këto shkolla për t'u regjistruar në universitetet në vend, mbetën të pazgjidhura. KOM-KO tha në shtator se nxënësit që kishin mbaruar arsimin e mesëm në shkollat e KOM-KO-së teknikisht nuk mund të regjistrohen në Fakultetin e Teologjisë të KOM-KO-së sepse ai financohet nga shteti dhe nuk mund të pranojë nxënës nga shkollat e mesme fetare. Megjithatë, vazhdoi regjistrimi i tyre.

Përfaqësuesit e BFI-së thanë se përkundër negociatave në vazhdim midis palëve të interesuara, qeveria vonoi akreditimin e medreseve të drejtuara nga BFI që dëshironin të merrnin akreditimin dhe se si rezultat i kësaj, nxënësit nuk mund të regjistroheshin në universitetet e financuara nga shteti. Më 22 shtator, nxënëset e medresesë së vajzave në Tetovë protestuan kundër vonesës së vazhdueshme nga ana e qeverisë për të akredituar shkollën e tyre si një institucion arsimor.

Disa grupe fetare dhe prindër vazhduan të thonë se priftërinjtë ortodoksë dhe hoxhallarët e punësuar për të ligjëruar lëndët mbi besimin dhe etikën pa theksim të ndonjë feje të caktuar shpesh theksonin praktikën e feve të tyre në vend që të paraqisnin një pasqyrë neutrale të besimeve të ndryshme. Zyrtarë të bashkësive fetare dhe të qeverisë thanë se këto lëndë u ndeshën me probleme të shumta shtesë sepse qeveritë lokale, që mbikëqyrin shkollat, përdorën rezultatet e sondazheve të prindërve të kryera në fillim të vitit shkollor për të caktuar lëndët për mësimdhënësit që i preferonin prindërit.

Më 27 janar, parlamenti miratoi një ligj mbi dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje që parasheh gjoba kundër grupeve fetare që nxisin dhunë në bazë gjinore dhe se mediat dhe komunitetet fetare duhet të promovonin politika kundër dhunës mbi baza gjinore. Ligji është në përputhje me Konventën e vitit 2011 të Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, e njohur më mirë si Konventa e Stambollit.

Më 5 mars, Ministri i Jashtëm Bujar Osmani, së bashku me drejtuesit e Entit Shtetëror të Statistikave dhe KMBFGR-së, u takuan me krerët e bashkësive kryesore fetare në vend për të diskutuar përgatitjet për regjistrimin e vitit 2021, i cili përfundoi më 30 shtator. Osmani i informoi ata mbi procesin e regjistrimit, theksoi rëndësinë e tij dhe u kërkoi atyre të ftojnë pjesëtarët e tyre për të marrë pjesë.

Në një intervistë më 5 prill me *European Jewish Press*, Rashela Mizrahi, gruaja e

parë hebreje që u bë ministre që nga pavarësia, foli rreth antisemitizmit me të cilin tha se ishte ndeshur kur u shkarkua nga posti i saj si ministre e punës dhe politikës sociale në vitin 2020 pas daljes së saj në një konferencë shtypi ku në sfond ishte shfaqur emri i mëparshëm i vendit, Maqedoni. “Kam marrë shumë kërcënime. Më kërkuan të vendosja yllin e verdhë. Kishte komente të botuara në media si ‘Treblinka nuk qe gabim,’ ‘Duhet t’i kishim shfarosur njëherë e përgjithmonë,’ dhe ‘Është gabim që disa prej tyre janë ende gjallë’” Mizrahi tha se i vinte keq që Kryeministri nuk shprehu kurrë “një qëndrim zyrtar” lidhur me kërcënimet. "Kjo fushatë zgjati për rreth gjashtë javë deri në shkarkimin tim nga parlamenti me arsyetimin se qëndroja përpara një afishe me emrin e vjetër të vendit." Mizrahi tha se partia qeverisëse, Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë, po shtrembëronte historinë e hebrenjve të vendit duke refuzuar të pranonte rolin e Bullgarisë (e cila, në atë kohë, pushtoi territorin që u bë Maqedonia e Veriut) në deportimin e tyre. Ajo tha: "Njerëzit e lindur midis 1980 dhe 1990 përgjithësisht nuk njohin historinë për shkak të mungesës së arsimit. Fëmijët duhet të edukohen për faktet e ndodhive gjatë Luftës së Dytë Botërore.”

Më 25 qershor, vendi paraqiti kërkesë zyrtare për anëtarësim të plotë në Aleancën Ndërkombëtare të Kujtimit të Holokaustit (IHRA), të cilën IHRA e miratoi në nëntor, gjatë seancës dimërore në Selanik, Greqi.

Më 13 tetor, Presidenti Pendarovski, në fjalimin e tij në Forumin Ndërkombëtar për Kujtimin e Holokaustit dhe Luftën kundër Antisemitizmit në Malmë, Suedi, theksoi nevojën për të ruajtur kujtimin e Holokaustit dhe fatit të 7,144 hebrenjve nga Maqedonia e Veriut që vdiqën në Treblinka në Poloninë e pushtuar në Luftën e Dytë Botërore dhe për të edukuar brezat e rinj mbi Holokaustin. Pendarovski tha se qeveria do të bënte të detyrueshëm dhe do të rriste numrin e orëve mësimore mbi antisemitizmin dhe Holokaustin në vitet e fundit të arsimit fillor dhe do të bënte të detyrueshme vizitat e shkollave fillore dhe të mesme në Qendrën Përkujtimore të Holokaustit në Shkup. Pendarovski vuri në dukje gjithashtu se qeveria kishte miratuar tashmë përkufizimet e punës së IHRA-s mbi antisemitizmin, mohimin dhe shtrembërimin e Holokaustit dhe anticiganizmin/diskriminimin kundër romëve.

Më 19 maj, koordinatori kombëtar për IHRA-n organizoi një seminar online shumëpalësh mbi zbatimin praktik të përcaktimeve të IHRA-s në shoqëritë shumë-kulturore. Me kërkesë të qeverisë në vitin 2020, Ministria e Arsimit dhe Shkencës vuri në dispozicion Rekomandimet e vitit 2019 të IHRA për *Nxënien dhe Mësimin e Holokaustit* në gjuhën maqedonase, shqipe, turke dhe serbe (gjuhët e mësimin në shkollat publike), me qëllim shpërndarjen e tyre në shkollat anëmbanë vendit. Byroja për Zhvillimin e Arsimit dhe Muzeu i Holokaustit botuan gjithashtu rekomandimet në ueb sajtet e tyre.

Më 28 prill, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Qendra Përkujtimore e Holokaustit, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe UNESCO organizuan një seminar për luftën kundër antisemitizmit në shkolla. Qendra Përkujtimore e Holokaustit përktheu dokumente të shkruara nga OSBE dhe UNESCO për luftën kundër antisemitizmin në maqedonisht, shqip, turqisht dhe serbisht.

Më 15 mars, BFI lëshoi një thirrje publike për myslimanët që t'u përmbahen rekomandimeve të qeverisë dhe udhëzimeve kundër KOVID-19. Duke ndjekur udhëzimet e qeverisë, BFI në Shkup vendosi më 8 prill të mbajë të mbyllura xhamitë për faljen tradicionale të natës së Ramazanit dhe të ndalojë darkat e iftarit në xhami për aq kohë sa ishte ora policore e KOVID-19. Atje ku kishte mundësi, në vend të kësaj organizoi namaze në internet dhe lutje në ambient të hapur. Në maj, gjithashtu në përputhje me udhëzimet e qeverisë, Rijaseti i BFI-së urdhëroi hoxhallarët të kufizojnë kohëzgjatjen e aktiviteteve në xhami sa më shumë të jetë e mundur dhe të ndalojnë tubimet e mëdha gjatë pandemisë.

Këshilli për fetvasë i BFI-së lëshoi një deklaratë më 9 prill për t'i informuar myslimanët në vend se marrja e vaksinave KOVID-19 nuk do të prishte agjërimin e Ramazanit. Më 30 gusht, kreu i BFI-së Fetahu dhe zëvendës ministri i shëndetësisë Ilir Hasani lëshuan një thirrje të përbashkët për publikun për t'u vaksinuar dhe për të respektuar rreptësishtë masat e vazhdueshme të qeverisë kundër përhapjes së KOVID-19. Hasani deklaroi para medias se i kishte kërkuar Fetahut t'u kërkonte hoxhallarëve të veprojnë në favor të vaksinimit masiv, duke shtuar se vaksinimi nuk ishte kundër ligjeve të fesë.

Në prill, Presidenti Pendarovski dhe drejtori i KMBFGR u takuan me krerët e katër prej pesë bashkësive fetare të renditura në kushtetutë: Kryepeshkopin Stefan të KOM-KO, kreun e BFI-së Fetahu, peshkopin Kiro Stojanov të Kishës katolike dhe mbikqyrësin Marjan Dimov të KUM-it. (Kryetari i komunitetit hebre ishte ftuar, por nuk mundi të marrë pjesë për shkak të sëmundjes.) Ata diskutuan se si të veprohet me kremtimet e festave të Pashkëve dhe të Ramazanit në kushtet e KOVID-19. Udhëheqësit e bashkësive fetare më pas u bënë thirrje besimtarëve të tyre për sjellje të përgjegjshme, respektim serioz dhe të pakushtëzuar të masave dhe rekomandimeve të shëndetit publik dhe nevojën për vaksinim.

Më 26 prill, kryeministri Zaev, zëvendëskryeministri i parë Artan Grubi, ministri i shëndetësisë Venko Filipçe dhe drejtori i KMBFGR Darijan Sotirovski falënderuan kryepeshkopin e KOM-KO Stefan dhe kreun e BFI-së Fetahu për mbështetjen e përpjekjeve të qeverisë për të luftuar pandeminë. Pjesëmarrësit në takim thanë se masat e mbrojtjes së shëndetit publik të qeverisë ndihmuan në reduktimin e numrit të infeksioneve dhe shtrirjeve në spital, gjë që krijoi kushte për kremtim më të sigurt të

Pashkëve ortodokse dhe të Bajramit. Zyrtarët përsëritën rëndësinë e strukturave fetare që vazhdojnë të zbatojnë kufizimet e qeverisë për KOVID-19.

Në qershor, KOM-KO lëshoi një mesazh në mbështetje të fushatës së qeverisë të imunizimit për KOVID- 19 dhe dënoi thirrjen e një prifti i cili u kërkoi famulltarëve të shmangnin vaksinimin sepse kjo qenka "kundër vullnetit të Perëndisë". Në deklaratimet publike, Sinodi i KOM-KO u bëri thirrje besimtarëve, klerit dhe murgjve të mos mashtrohen nga qëndrime të tilla.

Ateistët, myslimanët dhe hebrenjtë shprehën pakënaqësinë se përveç festave shtetërore që u jepen të gjithë qytetarëve, Ligji për festat u jep këtyre grupeve më pak ditë pushimi sesa u jep të krishterëve ortodoksë.

Në maj, Rijaseti i BFI-së u kërkoi hoxhallarëve dhe myftinjve të shmangin pjesëmarrjen në ngjarje politike me veshje fetare dhe të përmbahen krejtësisht nga pjesëmarrja në tubimet zgjedhore. Partitë e opozitës shqiptare etnike dhe media kishin deklaruar se disa përfaqësues të BFI-së kishin ndërhyrë në zgjedhjet e vitit 2017 dhe 2020 duke marrë pjesë në tubimet e partive politike, dhe se në këto zgjedhje ata kishin lobuar aktivisht në emër të partive në pushtet.

Pjesa III. Statusi i respektit shoqëror për lirinë fetare

Zyrtarët e KOO vazhduan të thonë se kleri dhe familjarët e tyre qenë shpesh objekt fyerjesh në media dhe viktime të sulmeve fizike nga individë që konsideroheshin të afërt me KOM-KO. Në gusht, personeli në një varrezë në Shkup refuzoi të lejonte peshkopin David të KOO-së të shërbente në një ceremoni varrimi përkundër këmbënguljes së familjes.

Në maj, protestuesit në mbështetje të një shteti palestinez u mblodhën para Muzeut të Holokaustit. Një numër i madh protestuesish brohoritën ofendime antisemitike. Komuniteti hebre nuk raportoi veprime të dhunshme kundër tyre por tha se gjatë përshkallëzimit të konfliktit në Gaza, disa nga pjesëtarët e saj ishin ankuar se fëmijët e tyre qenë ngacmuar për shkak të identitetit të tyre hebre - veçanërisht ata që ndiqnin shkollat ndërkombëtare së bashku me fëmijët e diplomatëve dhe afaristëve nga bota arabe. Gjatë konfliktit, pati një rritje të postimeve antisemite në mediat sociale.

Përfaqësuesit e Muzeut të Holokaustit thanë në shtator se kishin vënë re një rritje të postimeve antisemite në median sociale dhe përdorimin e Yllit të verdhë të Davidit në dezinformimin kundër vaksinimit, ku "bolshevikët, satanistët dhe hebrenjtë" fajësoheshin për KOVID-19.

Në shtator, ish-imami Skënder Buzaku, i cili njoftoi se do të kandidonte për t'u bërë

kreu i BFI-së, raportoi se kishte marrë kërcënime nëpërmjet mesazheve me tekst nga persona të panjohur që i thoshin se nuk do të bëhej kurrë udhëheqës dhe se në vend të kësaj do të burgosej e vritej. Sipas Buzakut, mesazhet gjithashtu i bënin thirrje të tërhiqte menjëherë akuzat e shpërdorimit që kishte ngritur në 2019 kundër ish kreut të BFI-së Sulejman Rexhepi dhe kreut aktual të BFI-së Fetahu ose përndryshe ai (Buzaku) do të "likuidohej." Buzaku e raportoi rastin tek zyrtarët e policisë që merren me krimin e dhunshëm. Policia nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për rastin deri në fund të vitit. BFI e përjashtoi Buzakun në vitin 2015 për rolin e tij në marrjen e përkohshme të selisë së BFI-së në Shkup nga mbështetës të armatosur.

Më 15 tetor, BFI dënoi atë që e quajti tallje me ritet fetare islame për qëllime politike nga kandidati për kryetar të komunës Shuto Orizares, Tefik Mahmut, anëtar i partisë opozitare Levica (E Majta). Mahmut organizoi një ezan të improvizuar në rrugë përpara ndërtesës së qeverisë në Shkup më 14 tetor. BFI e quajti tubimin e Levicës një "akt primitiv".

Komuniteti Bektashian (Tetovë) vazhdoi të kundërshtonte pretendimet e BFI-së për pronësi të plotë dhe planet për të rinovuar Harabati Baba Teqenë, një kompleks që Bektashinjtë (Tetovë) e përdornin si seli të veten. Komuniteti Bektashian (Tetovë) kundërshtoi gjithashtu planet e BFI-së për të rinovuar kompleksin, me ndihmë nga Turqia. Përfaqësuesit e komunitetit Bektashian (Tetovë) vazhduan të shprehin shqetësimin se rinovimi do të kryhej pa pëlqimin e tyre dhe se ai do t'i zhvendoste ata krejtësisht nga kompleksi, përveç që do të shkatërrojë trashëgimi me vlerë. Komuniteti Bektashian (Tetovë) nuk mund të çonte deri në fund kërkesën për pronësi për kompleksin sepse grupi mbeti i paregjistruar.

Media njoftoi për disa incidente të vjedhjeve nga manastiret ortodokse dhe KOM-KO njoftoi për 18 akte vjedhjesh apo vandalizmi të objekteve ortodokse gjatë vitit, duke përfshirë një në një zonë me shumicë myslimane. KOM-KO nuk ia mveshi vjedhjet dhe vandalizmin motiveve fetare.

Më 11 maj, individë të panjohur vandalizuan për herë të dytë në më pak se 12 muaj varret e Mehmet Pashë Derallës dhe Ali Vishkos, prijësve të shquar shqiptarë bektashi, në teqenë Harabati Baba në Tetovë.

Komiteti i Helsinkit në vend gjatë vitit regjistroi 30 incidente të gjuhës së urrejtjes me elemente fetare, krahasuar me 38 në vitin 2020. BFI shtoi se incidentet qenë përgjithësisht të kufizuara në publikime të rrejshme në median sociale dhe portalet e lajmeve.

Fondi i Holokaustit, një organizatë joqeveritare (OJQ), vazhdoi të punojë me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës në një projekt për të trajnuar mësuesin për të mësuar nxënësit e shkollave të mesme rreth Holokaustit dhe historisë së

hebrenjve. Fondi gjatë vitit mbajti tre seminare online dhe dy me prani fizike.

Më 28 shtator, Qendra Përkujtimore e Holokaustit hapi një ekspozitë të përshtatur për personat me dëgjim dhe shikim të dëmtuar. Qendra, e hapur në vitin 2020, vazhdoi të përkujtonte popullsinë hebreje në vend dhe ata që ishin dërguar në kampin e vdekjes Treblinka gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në pajtim me masat e KOVID-19, qendra zhvilloi programe edukimi rreth Holokaustit në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

Pjesa IV. Politika dhe angazhimi i qeverisë së SHBA-së

Ambasadorja amerikane dhe zyrtarë të tjerë të ambasadës diskutuan mbi dialogun ndërfetar, tolerancën dhe mirëkuptimin midis grupeve të ndryshme fetare me përfaqësues të qeverisë, përfshirë drejtorin e KMBFGR, kryetarët e komunave dhe zyrtarë të tjerë. Me deputetët, ata diskutuan gjithashtu gjendjen e lirisë fetare në vend, kthimin e pronës dhe amendamentet e ligjit për shkollat e mesme, duke përfshirë akreditimin e shkollave fetare.

Në mars, zyrtarët e ambasadës dhanë informacion për aplikimin e vendit për anëtarësim të plotë në IHRA, i cili u mbështet nga Fondi Përkujtimor i Holokaustit dhe pjesëmarrësit në një program shkëmbimi vizitorësh të financuar nga SHBA, si dhe nga aktivistët e shoqërisë civile, institucionet arsimore, komunitetet fetare dhe OJQ-të në mbarë vendin që punojnë në fushën e dialogut ndërfetar dhe lirive fetare.

Zyrtarët e ambasadës u takuan me kreun e BFI-së Fetahu dhe Kryepeshkopin e KOM-KO Stefan për të diskutuar çështjet e lirisë fetare, duke përfshirë favorizimin e perceptuar të qeverisë ndaj disa grupeve fetare. Zyrtarët e ambasadës u takuan gjithashtu me përfaqësues të grupeve të tjera fetare për të diskutuar çështjet e lirisë fetare, duke përfshirë trajtimin nga qeveria të grupeve më të vogla dhe respektimin e lirisë së tyre fetare.

Ambasada postoi 15 mesazhe në median sociale lidhur me lirinë fetare gjatë vitit, që kanë arritur te më shumë se 64,000 ndjekës. Temat përfshinin Ditën Ndërkombëtare të Lirisë Fetare dhe Ditën Kombëtare të Lirisë Fetare.